

NJOFTIM

Gjykata e Apelit Tiranë vlerëson maksimalisht marrëdhëniet e gjykatës me publikun dhe posaçërisht me median, e cila luan rolin e rojtarit publik, nëpërmjet marrjes dhe publikimit të informacionit, që lidhet me mënyrën e funksionimit të pushtetit gjyqësor.

Jemi të lumtur t'Ju njoftojmë se në organikën e Gjykatës së Apelit Tiranë, u shtua edhe funksioni i Specialistit të Marrëdhënieve me Median dhe Publikun. Ky funksion do të përmbushet nga **Znj. Jonida Capo**.

Sipas nenit 46 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” :

“1. Shërbimet për marrëdhëniet me publikun kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim që:

a) t'i sigurohet medias dhe publikut informacion faktik rreth vendimeve gjyqësore dhe për korrigjimin e gabimeve të mundshme mbi faktet për çështje të caktuara;

b) t'i komunikohet medias përmbledhje e vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes publik;

c) të mbahen kontakte me median për seancat gjyqësore të çështjeve që kanë interes të veçantë publik;

ç) të sigurohet informacion, në përputhje me ligjin “Për të drejtën e informimit”, në veçanti në lidhje me çështjet në gjykim dhe administratën gjyqësore;

d) të publikohen të gjitha vendimet gjyqësore në përputhje me ligjin.

2. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë.

3. Shërbimi i marrëdhënieve me publikun ndërvepron dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor mbi ecurinë e marrëdhënieve me publikun pranë gjykatave dhe kërkon mendimin e tij kur është e nevojshme.

4. Këshilli i Gjykatës cakton nëpunësin civil gjyqësor për marrëdhëniet me publikun si koordinator, në përputhje me ligjin për kompetencat e koordinatorit për të drejtën e informimit.

5. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun ushtrohen nga ose nën mbikëqyrjen e gjyqtarit të caktuar për marrëdhëniet me publikun.”

Me qëllim përmbushjen e detyrimit për dhënien e informacionit, në përputhje me ligjin, Gjykata e Apelit Tiranë, angazhohet maksimalisht për të dhënë në kohë sa më të shpejtë çdo informacion mbi çështje, që lidhen me funksionimin e saj.

Duke besuar se një gjyqësor transparent kontribuon në shtimin e besimit të publikut, Gjykata e Apelit do të informojë edhe pa kërkesë të medias, informacione mbi çështje me interes publik.

Për çdo informacioni të mundshëm që lidhet me veprimtarinë e gjykatës, lutemi të ndiqni faqen e internetit <http://www.gjykata.gov.al/apel-tiran%C3%AB/gjykata-e-apelit-tiran%C3%AB/> në kategorinë e dedikuar “*Njoftime për publikun*” dhe “*Njoftime për median*”, si dhe në adresën e e-mailit jonida.capo@gjykata.gov.al dhe numrin e kontaktit **0685713708**.